URDHËR
Nr. 73, datë 17.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë zëvendësministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për nënshkrimin e:

a) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit për aplikimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), për t'u pajisur me leje minerare;

b) njoftimit për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare;

c) njoftimit për ndërprerjen e procedurave të fillimit të revokimit të lejeve minerare;

ç) vendimit për revokimin e lejeve minerare;

d) aktit për pasqyrimin dhe miratimin e ndryshimeve të të dhënave në lejet minerare;

dh) aktit të miratimit ose të refuzimit të lejes së kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit për zgjatjen e afateve, ndryshimin e koordinatave, transferimin e lejeve minerare;

e) aktit të dhënies së të drejtës së aplikimit në QKB, për zonat e hapura për qëllime publike;

ë) aktit për miratimin e nënkontraktimeve;

f) shkresës së korrespondencës me QKB-në për sektorin minerar;

g) miratimit dhe refuzimit të aplikimeve për autorizimet për personat juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, për përdorim civil të lëndëve plasëse;

gj) urdhrit për kthimin, apo moskthimin e garancive financiare të rehabilitimit dhe të investimit;

h) urdhrit për miratimin e projekteve shtesë të veprimtarive minerare;

i) aktit të njoftimit të pezullimit të lejes së shfrytëzimit me minierë sipërfaqësore të mineraleve dhe të grupit të mineraleve ndërtimore, si dhe për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet.

2. Në ushtrimin e kompetencave të deleguara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, i ndjek dhe i zbaton ato në mbështetje të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dhe të ligjit nr. 74/2021, "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil", dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, brenda fushës së përgjegjësisë së përcaktuar në këtë urdhër.

3. Kompetencat e deleguara, sipas pikës 1, ushtrohen nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhri deri në miratimin e një urdhri të dytë.

4. Urdhri nr. 42, datë 2.2.2026, "Për delegim kompetence", i zëvendëskryeministrit dhe i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shfuqizohet.

5. Ngarkohet zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Erlind Sulo, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi